



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.181/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bektashi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.181/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent me seli në Prishtinë, kundër subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 02.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se, kandidati për deputet nga radhët e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Mefail Bajqinovci, pa leje paraprake ka incizuar një spot brenda hapësirave të objektit të njërive profesionale të zjarrëfikjes dhe shpëtimit konkretisht në stacionin “Prishtina 2” në Vranjevc. Më tutje parashtruesi thekson se kjo video – incizim është publikuar në profilin e tij në rrjetin social facebook, dhe i njejtë vazhdon të qarkullon dhe të shpërndahet, AME njofton se shërbimi i zjarrëfikjes dhe shpëtimit është shërbim publik dhe kështu kandidati në fjalë ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të rregullës zgjedhore 11/2013.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tyre.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2019 konsideron se Agjencia e Menaxhimit Emergjent nuk ka legjitimitet aktiv për ushtrimin e kësaj ankesë, sipas nenit 119 par.1 të LPZ-së, më tutje në përgjigje subjekti politik LVV, thekson se kjo video është xhiruar para fillimit të fushatës zgjedhore dhe nuk është shkelur asnjë dispozitë ligjore, kjo vërtetohet me anë të fotove që i kemi bashkangjitur në përgjigje. Në fund, i propozojmë panelit, që ankesa të refuzohet si e palejuar dhe e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, për shkak të mungesës së provave, sepse i njejtë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi ankesës lidhur me pretendimet e tyre, kështu duke vepruar në kundërshtim me Rregullën 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat”, përkatësisht nenin 5 par.7 i kësaj rregulle.

Ankuesi përveq ankesës së tij dhe pretendimeve nga e njëjta nuk ka saktësuar, kohën kur është zhiruar dhe publikuar spoti në fjalë, e madje provën kryesore në rastin konkret nuk e dorëzon në pzap, andaj në mungesë të argumentuesis në raport me pretendimet e tij ankesa e të njëjtit refuzohet e pa bazuar.

Nga arsyet e theksuara më lartë, duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.181/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.